



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

24 Mars 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ZHURNAL [®]
Agjenci e Lajmeve

Laborator i ri për zbulimin e hershëm të tuberkulozit në Institutin për sëmundje të mushkërive

Shkup, 23 mars - Instituti i sëmundjeve të mushkërive, fitoi një laborator modern për zbulimin e hershëm të tuberkulozit. Në aparatet e reja mjekët mund të zbulojnë infeksion latent, respektivisht personi të jetë i infektuar, por nuk është i rrezikshëm për mjedisin për shkak se nuk ka simptoma të sëmundjes.

“Është shumë preciz dhe na tregon nëse dyshimi, infektimi mund të kalojë në sëmundjen”, thonë në TBC

Investimi është me vlerë 8.5 milionë dhe është pjesë e një projekti qeveritar për pajisjen e 80 laboratoreve për qëllime shkencore, njofton Zhurnal.

Koha
E PËRDITSHME INFORMATIVE

Fëmija i tretë rrit natalitetin te shqiptarët



Nga 21 mijë nëna shfrytëzuese të ndihmës shtetërore për fëmijën e tretë, brenda gjashtë viteve, 9994 janë shqiptare dhe rreth 6000 mijë maqedonase, ndërsa shfrytëzues të pjesës së mbetur janë nga bashkësitë e tjera etnike që jetojnë në Maqedoni

Fisnik PASHOLLI

Shqiptarët del të jenë përfituesit më të mëdhenj të ndihmës shtetërore për fëmijën e tretë, që zbatohet si masë për rritjen e natalitetit në gjashtë vitet e fundit.

Hulumtimi i Institutit "Zip" dhe "Finance Think", tregon se afër gjysma e shfrytëzuesve të përgjithshëm të ndihmës shtetërore për fëmijën e tretë janë nëna shqiptare, kurse e njëjta arrin 8000 denarë në muaj.

"Prej vitit 2009 e deri në muajin nëntor të vitit 2015, prej 21 mijë nënave shfrytëzuese të kësaj mase, 9.994



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



janë shqiptare dhe rreth 6000 mijë janë maqedonase, ndërsa shfrytëzues të pjesës së mbetur janë nga bashkësitë e tjera etnike që jetojnë në Maqedoni. Kjo do të thotë se kjo masë dukshëm ka stimuluar natalitetin te shqiptarët", thotë Fexhri Selami nga Instituti "Zip". Megjithatë, hulumtimi kushtuar efekteve të projektit qeveritar për subvencionimin e fëmijës së tretë tregon se ai nevojitet të rishqyrtohet dhe zgjerohet, me qëllim që të stimulojë edhe lindjen te familjet që nuk kanë fëmijë si dhe te ato që kanë një fëmijë, e gjithë kjo me qëllim të rritjes së natalitetit në Maqedoni. Ndihamat shtetërore për fëmijën e tretë që familjet i pranojnë në një afat prej dhjetë vitesh e kanë rritur numrin e lindshmërive të fëmijëve të tretë në Maqedoni, por njëkohësisht është regjistruar ulje e lindshmërive të fëmijëve të parë dhe të dytë, tregon hulumtimi i nga Instituti "Zip" dhe "Finance Think". "Duke marrë parasysh se shkalla e fertilitetit në vitin 2009 ishte 1.48, ndërsa në vitin 2014 është ulur në 1.47, si dhe faktin se në vitin 2009 kemi shtim natyror prej 2.3 fëmijë kurse në 2014-tën kishim shtim natyror prej 1.5 fëmijë, nevojitet që të ridizajnohen masat e këtilla shtetërore, pasi fare pak ka pasur lëvizje rritja e natalitetit në shtet. Kjo nënkupton edhe hapjen e çerdheve në vendbanimet rurale si dhe shumë masa të tjera", shton Selami. Hulumtimi mes tjerash tregon se numri i fëmijëve të tretë të lindur ka efekt të vogël në shtimin natyror, përveçse se në vitin 2009 dhe 2010, kur paguhej edhe shtesa për fëmijën e dytë dhe të tretë. "Nga viti 2011 e deri në vitin 2014 shkalla e shtimit natyror është më e vogël edhe se në vitin 2006, kur ka qenë 1.9. Kjo udhëzon në faktin se efektet e masës nuk korrespondojnë me qëllimin e vendosur, gjegjësisht numri i lindur i fëmijëve të tretë nuk është i mjaftueshëm të kompensojë mungesën e fëmijëve të parë dhe të dytë të lindur në numrin e përgjithshëm të foshnjave të lindura", theksohet në hulumtim. Edhe statistika zyrtare të shtetit tregojnë gjithnjë e më pak lindin fëmijë të parë dhe të dytë, që do të thotë se të rinjtë më vështirë vendosen për fëmijën e parë, ndërsa ato që kanë fëmijën e parë, gjithashtu më rëndë vendosen për fëmijën e dytë. Të dhënat tregojnë se numri i fëmijëve të tretë të lindur në 2014 ka qenë 3336, ndërsa në vitin 2009 kur u vendosë masa dhe në vitet paraprake ishte në rënie të vazhdueshme. Në vitin 2104 janë lindur 3196 fëmijë të parë më pak se në vitin 2002, ndërsa po këtë vit janë lindur edhe më pak fëmijë të dytë të krahasuar me të njëjtën periudhë, respektivisht 1835. Nga ana tjetër sipas ekspertëve demografik ekzistojnë më shumë masa për rritjen e natalitetit, por kryesorja mbetet përmirësimi i standardit jetësor të qytetarëve, pasi shumica e çifteve mendojnë së pari të sigurojnë një vend punë, mirëqenie, banesë dhe pastaj të mendojnë për fëmijët pasi t'i afrohen moshës 30 vjeçare. Se Maqedonia ka problem me natalitetin, këtë e vërteton krahasimi i shifrave të fundit me ato të viteve të pasluftës së dytë botërore. Nëse në vitin 1950 në Maqedoni kanë lindur 50.000 foshnje në vit, sipas të dhënave të fundit të Entit të Statistikë, lindshmëria në vitin 2013 ka rënë në vetëm 23.334 foshnje. Trendi i uljes së vazhdueshme të natalitetit në



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



dekadat e kaluara mbështetet edhe me faktin se dhjetë vite më vonë, respektivisht në vitin 1960 kanë lindur 42 mijë foshnje, kurse 39.784 në vitin 1980. Brenda 20 viteve lindshmëria ra edhe më ndjeshëm dhe në vitin 2000 janë lindur vetëm 29.000 foshnje. Kjo do të thotë se prej vitit 1950 e deri në vitin 2013 në Maqedoni janë lindur dyfish më pak fëmijë, apo për 63 vjet numri i foshnjave të lindura ishte zvogëluar për 27.000.

PORTALB
dritare realiteti

Ndotja e ajrit në Tetovë do të matet nga tre stacione lëvizëse



Nga muaji i ardhëshëm, ndotja e ajrit në Tetovë do të matet nga tre stacione të lëvizshme, projekt në të cilin është duke punuar Instituti për mjedis jetësor pranë Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL), transmeton [Telegrafi Maqedoni](#).

Sipas Darko Spirovskit nga ky institut, nuk mund të fitohen të dhënat e sakta të ndotjes së ajrit në Tetovë vetëm me një stacion matës, ndërkaq nëse matet në më shumë vende, atëherë të dhënat janë më të sakta.

Nga Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinorë, që janë ndihmësit financiar të projektit, thonë se janë duke punuar vazhdimisht në plan të uljes së ndotjes së ajrit dhe të zbulimit të burimeve të ndryshme të ndotjes, si edhe në përgatitjen e masave të duhura për uljen e saj.

Komuna e Tetovës liron nga pagesa e parkimit zonal personat me nevoja të veçanta



Komuna e Tetovës përmes një deklarate për shtyp ditën e djeshme të Drejtorit të NP "Parkingjet e Qytetit" Fejsal Beadini, dhe sot përmes një shpërndarje të informacioni sot në rrjetin social [Facebook](#) në faqen e Kryetares së Komunës Teuta Arifi ka bërë të ditur që liron nga obligimi i pagesës së parkimit zonal personat me nevoja të veçanta. Ky gjest shpreh një komunë solidare ndaj qytetarit.

Ndryshe, parkingjet në vendet evropiane dhe gjetiu kanë hapësirë të veçanta të siguruar dhe pa pagesë për personat me nevoja të veçanta.